

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Publikohen rezultatet e reja ODIN 2017 – Kosova e 8-ta në nivel të Evropës Jugore, ndërsa e 68-ta në nivel bote

07. 03. 2018




OPEN DATA WATCH

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) tashmë ka marrë njoftimin e publikimit të rezultateve më të reja të Raportit vjetor të Open Data Inventory (ODIN 2017) për shpërndarjen e statistikave zyrtare në format të hapur në nivel bote dhe ndarjeje kontinentale. Ky vlerësim e rendit Kosovën në vendin e 68-të në nivel bote dhe në vendin e 8-të në nivel të Evropës Jugore.

Region	Overall Score		Coverage Score		Openness Score				
	Rank	Score	Rank	Score	Rank	Score			
Southern Europe	8	Slovenia	69	13	Italy	56	5	Slovenia	83
	15	Portugal	64	15	Portugal	55	15	Portugal	72
	16	Italy	63	17	Slovenia	54	18	Italy	68
	19	Spain	58	18	Spain	53	21	Spain	63
	20	Macedonia, FYR	57	19	Macedonia, FYR	53	22	Macedonia, FYR	62
	24	Albania	54	23	Albania	51	26	Albania	58
	31	Greece	48	31	Kosovo	43	28	Greece	55
	33	Kosovo	44	33	Croatia	42	31	Malta	46
	34	Croatia	43	34	Greece	40	32	Kosovo	44
	36	Malta	42	35	Montenegro	40	33	Croatia	43
	38	Montenegro	38	36	Bosnia and Herzegovina	37	37	Serbia	39
	39	Serbia	37	37	Malta	35	39	Montenegro	36
	40	Bosnia and Herzegovina	35	38	Serbia	35	40	Bosnia and Herzegovina	33
41	Andorra	29	42	Andorra	24	41	Andorra	32	

Në tri fushat e anketuara, Kosova paraqitet të ketë bërë progres mjaft të madh në shpërndarjen e të dhënave statistikore në format të hapur, krahasuar me vitin 2016, si në nivel bote e 68-ta (që ishte e 82-ta në rend), ashtu edhe në nivel të Evropës Jugore e 8-ta (që ishte e 12-ta në rend). Nga vendet e Evropës Jugore, në ODIN 2017, Kosova lë pas Kroacinë, Maltën, Malin e Zi, Serbinë, Bonjë e Hercegovinën dhe Andorën.


Grafi 1: Rangimi i Kosovës në nivel të Evropës Jugore dhe në nivel bote



Në vlerësimet e agreguara të Raportit vjetor ODIN 2017 janë përfshirë 21 kategori dhe 10 elemente, që karakterizojnë tri fusha kryesore të vlerësimit - statistikat sociale, statistikat ekonomike dhe statistikat e mjedisit. Kurse, rezultatet janë të ndara në një shkallë nga 0 në 100. Në këtë vlerësim janë paraqitur 180 vende të botës, përfshirë edhe shumicën e vendeve të OECD-së. Shih renditjen në nivel bote në:

<http://odin.opendatawatch.com/report/rankings>

Grafi 2: Pikët sipas kategorive të të dhënave



ODIN është i vetmi vlerësim i mbulueshmërisë dhe qasjes së hapur i të dhënave në ueb-faqet e mirëmbajtura nga Zyret Kombëtare të Statistikave.

Pas vlerësimit pozitiv ndërkombëtar të Sistemit Statistikor të Kosovës përmes Raportit “Peer Review 2017”, ky është edhe një vlerësim jashtëzakonisht pozitiv për Kosovën në përgjithësi dhe për ASK-në në veçanti.

Për më shumë informata lidhur me Raportin ODIN 2017 vetëm për Kosovën, vizitoni:

<http://odin.opendataëatch.com/Report/countryProfile/XKX?appConfigId=4>